

## NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:  
**Specialist i Çështjeve Ligjore për Komunikimet Elektronike dhe Postare-AKEP**

**Procedura :** **PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) njofton se:

- **Z. Doris Qirjako** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.
- **Z. Glorian Tusha** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

### **Konkurimi:**

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr. Reshit Çollaku, në datën **15.09.2020** ora **10:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr. Reshit Çollaku, në datën **15.09.2020** ora **13:00**.

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv në AKEP- KPP, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Specialist i Çështjeve Ligjore për Komunikimet Elektronike dhe Postare**.

Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, Kreu IV, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi 70%) do të njoftohet në datën **15.09.2020**.

**Njoftimi do të publikohet:** në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **21.09.2020**.

*Njësitia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)*